



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

**OPINION MBI KANDIDATIN Znj. MARSIDA FRASHERI**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 20.02.2020 me postë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Marsida Frasheri dërguar ne dt 19.02.2020, e cila është caktuar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar çënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurorja Marsida Frashëri ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2009, pasi me dekretin nr. 6293, datë 12.10.2009 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në

stash ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Nga dosja personale rezulton se është emëruar me dekretin e presidentit nr. 6749, date 02.11.2010 si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku ushtron detyrën aktualisht.

Znj. Marsida Frashëri ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 11 (njëmbëdhjetë) vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr. 1685 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër rezulton se kjo Prokurori ka një ngarkesë të madhe ne punë dhe angazhimi i znj. Frashëri është me rëndësi. Nga ana e Drejtuesit vlerësimi i rrethanave edhe në përputhje me interesin e Këshillit, i lihet këtij të fundit.

Në këto rrethana Komisioni vlerëson se komandimi i znj. Frashëri do të cënonte mbarëvajtjen e punës dhe interesin më të lartë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

*Përfundimisht nga kandidimi për komandim të prokurores Marsida Frashëri, për shkak se komandimi i saj do të ndikonte veprimtarinë normale të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.*

## **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

Datë: 24.02.2020